



Në bazë të nenit 10 të Ligjit për Qytetin e Shkupit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr 55/04 dhe 158/11) dhe në përputhje me Programin për aktivitetet e Qytetit të Shkupit në fushën e arsimit të mesëm në vitin 2020 ("Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit" nr. 17/2019), Qyteti i Shkupit shpall:

**Thirrje publike  
për mbledhjen e kërkesave  
për shfrytëzimin e mjeteve nga Buxheti i Qytetit të Shkupit  
për vitin 2020, të dedikuara për financimin e përbashkët të aktiviteteve  
programore të shoqatave, fondacioneve dhe personave të tjerë juridikë**

**①. E drejta për pjesëmarrje**

1.1 Të drejtë për pjesëmarrje në Thirrje publike kanë shoqatat, fondacionet dhe persona të tjerë juridikë.

**②. Korniza kohore dhe mënyra e shpërndarjes së mjeteve**

2.1 Shpërndarja e mjeteve nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2020 (Programi N2 Shërbime për aktiviteteve shkollore jashtëshkollore në bashkëpunim me organizata joqeveritare zëri 425 konto 425750) të dedikuara për financimin e përbashkët të aktiviteteve programore të shoqatave, fondacioneve dhe personave të tjerë juridikë, do të realizohet në bazë të kriterëve dhe prioriteteve të përcaktuara në këtë thirrje.

**③. Lloji i projekteve që do të përkrahen**

3.1 Mjetet nga Buxheti i Qytetit të Shkupit, me shumë të përgjithshme 3.500.000 denarë do të shfrytëzohen për financimin e përbashkët të aktiviteteve programore të shoqatave, fondacioneve dhe personave të tjerë juridikë, nëpërmjet grave për projekte nga fusha e arsimit të orientuara ndaj prioriteteve të mëposhtme:

1. Krijimi i mjedisëve të sigurt shkollorë (Ndihma psiko–sociale e anëtarëve të bashkësisë shkollorë për ballafaqim me dhunën përmes sigurimit të përkrahjes profesionale për zbatim rigoroz të mekanizmave dhe protokolleve të miratuara për punë, si dhe promovimi i sistemit të vlerave pozitive);
2. Hulumtimi dhe promovimi i barazisë gjinore, të drejtave të nxënësve, lirive dhe zhvillimit të kreativitetit – përfshirja e nxënësve

të shkollave të mesme në hulumtime të kryera nga ekspertë me qëllim sensibilizimin e drejtë për gjendjen në lidhje me të drejtat e nxënësve në sistemin arsimor, liritë e tyre, barazinë gjinore, tolerancën dhe mosdiskriminimin dhe tema të tjera të rëndësishme të cilat nuk janë përfshirë në programet e rregullta arsimore. Veçanërisht do të përkrahen projektet multimediale dhe aktivitetet të cilat do të nxisin lirinë e shprehjes dhe zhvillimin e potencialit kreativ të të rinjve të shkollave të mesme.

3. Përkrahja e zhvillimit të karrierës individuale të nxënësve do të fokusohet në fuqizimin e kapaciteteve të arsimtarëve për punë në fushën e këshillimit të karrierës, dhe në drejtim të ofrimit të ndihmës çdo nxënësi në ndërtimin e planit individual të karrierës së tyre;
4. Organizimi i manifestimeve në të cilat do të prezantohen arritjet shkollore, do të promovohen nxënësit më të mirë si dhe do të prezantohen rezultatet e veprimtarisë edukative – arsimore para opinionit më të gjerë.

#### ④. Kriteret themelore të organizimit

4.1 Kriteret themelore të organizimit, të cilat duhet t'i përmbushin shoqatat, fondacionet dhe personat e tjerë juridikë të cilët marrin pjesë në këtë thirrje janë:

- o Të jenë regjistruar në Regjistrin Qendror me seli në Shkup;

#### ⑤. Vlerësimi i cilësisë së projekteve

5.1 Vlerësimi i cilësisë së projekteve të shoqatave dhe fondacioneve dhe personave të tjerë juridikë të cilët përmbushin kriteret themelore të organizimit, do të realizohet në bazë të këtyre kriterëve të veçanta programore:

<b>Fusha</b>	<b>Pikë maksimale</b>
<b>1. Struktura organizative dhe resurset</b>	<b>40</b>
1.1 Vlerësimi i cilësisë së strukturës organizative për realizimin e projektit (të punësuar, vullnetarë aktivë, persona të angazhuar me honorar)	10
1.2 Ekspertë të cilët marrin pjesë në zbatimin e projektit	10
1.3 A disponon shoqata, fondacioni, dhe personat e tjerë juridikë me ambient për zyrë dhe me pajisje teknike për realizimin e projektit	10
<b>2. Financimi i përbashkët i projektit</b>	<b>10</b>
2.1 A siguron shoqata, fondacioni dhe personat e tjerë juridikë më shumë se 15 % të pjesëmarrjes së vetë	10

gjatë realizimit të projektit	
2.2 A është real plani financiar i propozuar (përshkrimi i shpenzimeve sipas kategorive/pozicioneve korrespondon me çmimet e tregut )	
<b>3. Cilësia e projektit</b>	<b>50</b>
3.1 Në çmasë qëllimi i përgjithshëm i projektit do të kontribuojë për realizimin e prioriteteve të përcaktuara, sa është i qartë dhe i përcaktuar në mënyrë adekuate	10
3.2 Zgjidhje me cilësi dhe inovative të ofruara në propozim-projekt	10
3.3. Sigurimi i përfshirjes së institucioneve dhe organizatave të tjera	10
3.4. A është plani i realizimit të projektit i qartë dhe i realizueshëm	10

5.1 Çdo fushë e kritereve të posaçme programore, do të vlerësohet me 1 pikë, 5 pikë ose 10 pikë, që nënkupton: 1 - jo, 5 - pjesërisht dhe 10 - po.

**⑥. Dokumentacioni i nevojshëm të cilin shoqata/fondacioni/personi juridik duhet ta depozitojë së bashku me Fletëparaqitjen për përkrahje financiare të shoqatave, fondacioneve dhe personave juridikë**

6.1 Përveç Fletëparaqitjes për përkrahje financiare të shoqatave, fondacioneve dhe personave juridikë, e cila duhet të jetë e plotësuar (me shkronja shtypi në alfabetin cirilik), **të nënshkruar nga personi i cili është i autorizuar që ta përfaqësojë shoqërinë, fondacionin ose personin juridik**, dhe të vërtetuar me vulën e shoqatës, fondacionit ose personit juridik, detyrimisht duhet të depozitohen edhe këto shtojca:

- Fotokopje të aktvendimit për regjistrim në Regjistrin Qendror;
- Fletëparaqitje dhe Formular i plotësuar në kompjuter;
- Vërtetim për tatimet e paguara, të lëshuar nga organet tatimore
- Vërtetim për detyrime të paguara ndaj Qytetit të Shkupit (tatim, taksa komunale);
- Deklaratë për Projektin e propozuar se nuk janë marrë mjete financiare nga buxheti i Qytetit të Shkupit gjatë vitit në vijim dhe, se i njëjti nuk do të bashkëfinancohet nga Buxheti i Qytetit të Shkupit deri në përfundimin e tij.

**⑦. Dokumentacioni përcjellës**

7.1 Shoqatat, fondacionet dhe personat juridikë, të bashkëngjitur mund të depozitojnë edhe dokumentacionin përcjellës të mposhtëm:

- buxhet vjetor i aplikuesit për vitin në vijim,
- biografi profesionale e ekspertëve të cilët do të angazhohen në realizimin e projektit,

- listë referente ose dëshmi (p.sh.:kontratë e nënshkruar) për më së paku 2 projekte të realizuara nga fusha për të cilën aplikohet,
- më së paku dy mendime/referenca nga partnerë ose donatorë për realizim të projekteve të mëparshme, dhe
- përkrahje me shkrim nga organizata ose institucione për të cilat është planifikuar që të marrin pjesë në realizimin e projektit.

7.2 Shoqatat, fondacionet dhe personat juridikë, mund të depozitojnë më shumë se një fletëparaqitje për përkrahje financiare në lidhje me këtë thirrje publike.

7.3 Në propozim – projektin e depozituar, shoqatat, fondacionet dhe personat juridikë duhet të përcaktohen për një nga prioritetet, në suazat e të cilit do ta realizojnë projektin.

**Vërejtje: Fletëparaqitjet me dokumentacion të pakompletuar ose të depozituar pas përfundimit të afatit të parashikuar, nuk do të shqyrtohen! Shtojcat e depozituara nuk kthehen.**

## ⑧. Mënyra e realizimit e thirrjes publike

8.1 Vlerësimi i projekteve do të realizohet nga Komisioni i formuar nga ana e Kryetarit të Qytetit të Shkupit.

8.2 Projektet të cilat pas përfundimit të vlerësimit nga ana e komisionit do të vlerësohen me minimum 55 pikë do të kualifikohen për marrjen e përkrahjes financiare nga Qyteti i Shkupit.

8.3 Kryetari i Qytetit të Shkupit me propozim të Komisionit nga dita e përfundimit të Thirrjes publike do të lidhë kontratë për shfrytëzimin e mjeteve me ato shoqata, fondacione dhe persona juridikë të cilët janë kualifikuar për marrjen e mjeteve financiare për përkrahje. Shfrytëzimi i mjeteve të ndara do të rregullohet në bazë të Kontratës së lidhur me Qytetin e Shkupit.

8.4. Shoqatat, fondacionet dhe personat juridikë propozim-projektet e të cilave do të bashkëfinancohen nga ana e Qytetit të Shkupit, nuk do të kenë të drejtë t'i ndryshojnë aktivitetet dhe kornizën kohore për realizimin e tyre, të përshkruara në projektin me të cilin kanë aplikuar dhe që është pranuar nga ana e komisionit, përveç rastit kur kanë marrë pëlqim paraprak nga Qyteti i Shkupit.

## ⑨. Afati dhe mënyra e depozitimit të fletëparaqitjeve

9.1 Afati i depozitimit të fletëparaqitjeve është 15 ditë nga dita e shpalljes në gazetën ditore, pikërisht i njëjti do të zgjasë nga data 25.01. deri më 08.02. 2020.

9.2 Fletëparaqitja me dokumentacionin e plotë, duhet të depozitohet nëpërmjet postës në adresën: **Qyteti i Shkupit, Sektori për arsim, bul. "Ilindenska" nr. 82, 1000 Shkup**, ose në arkivin e Qytetit të Shkupit deri në **orën 15** (me shënimin – Sektori për arsim – Fletëparaqitje për thirrje publike).

9.3 Shoqatat, fondacionet dhe personat juridikë, pjesëmarrës në thirrjen publike do të njoftohen për rezultatet në një afat prej 10 ditësh nga dita e sjelljes së Vendimit për shpërndarjen e mjeteve nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2020, të dedikuara për financimin e përbashkët të aktiviteteve programore të shoqatave, fondacioneve dhe personave juridikë.

**Fletëparaqitja për realizimin dhe financimin e përbashkët të projekteve nga fusha e arsimit, dhe Formulari, mund të shkarkohen nga faqja e internetit e Qytetit të Shkupit [www.skopje.gov.mk](http://www.skopje.gov.mk) në pjesën Shpallje, konkurse, evente – Thirrje publike.**

Pyetjet për sqarime plotësuese, mund të depozitohen me shkrim ose në formë elektronike pranë Sektorit për arsim.

**Kontakt: Sektori për arsim, tel: (02) 3297-317, e - mail: [maja.atanasijevik@skopje.gov.mk](mailto:maja.atanasijevik@skopje.gov.mk).**